-93-

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**KESHILLI KOMBETARE I UJIT**
**KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

Adresa: Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore,Kati 3-te.

**Nr.__94__Prot** **Shkoder, dt._22.09._2009**

## I N F O R M A C I O N

### "MBI PERDORIMIN E BURIMIT UJORE PERROI MEZI - ARSTIT FSHATI ARST PER PRODHIM TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SHOQERIA " 2 A POWER" sh.p.k." HEC "ARST".

Bazuar ne kerkesen e pa kerkuar te bere nge shoqeria " 2 A POWER "sh.p.k. per perdorim te burimit ujor perroi Mezi - Arstit , per prodhim energjie elektrike nen 15 MW, dhe se propozimi i mesiperm, sipas dokumentacionit qe disponon K.B.U. Drin-Bune, nuk ka te beje me projekte, per te cilat ka filluar apo eshte shpallur procedura e perzgjedhjes.

Sipas dokumentacionit te paraqitur nga subjekti i mesiperm vepra e marrjes se ujit, do te ndertohet ne perroin Mezi – Arstit, ne kuoten + 600 m mbi nivelin e detit. Ndertesa e HEC-it do te ndertohet ne kuoten + 300 m. Prurja mesatare eshte Q= 0.69 m3/sek.. Subjekti kerkon te shfrytezoje nje prurje prej Q = 0.925 m3/sek..

Subjekti gjate gjithe vitit nuk do pengoje furnizimin me uje te zones.

Ky informacion jepet nga K.B.U.Drin-Bune Shkoder, bazuar ne nenet 4, 5, 9 dhe 23 te ligjit nr. 9663 dt. 18.12.2006 " PER KONCESIONET" dhe ne zbatim te tij te germes b, pika 3, kreu IV i V.K.M. nr. 87 dt. 16.01.2008 "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007, te KM., "Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe dhenies se koncesioneve " , te ndryshuar, per plotesim dokumentacioni.

**PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE**

**Sekretari**

**Xhelal Bajraktari**

**Kryetari**

**Maxhid CUNGU**

Mora nje kopje "2A Power" shpk.